



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike
Mbledhja nr. 16
Prishtinë, më 06 korrik 2010, në orën 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Haki Shatri, Kosara Nikoliq, Naser Osmani, Anita Morina-Saraçi, Riza Smaka, Synavere Rysha dhe Enis Kervan.

Munguan: Safete Hadergjonaj dhe Gani Koci.

Të ftuar: Ejup Hashani, Skënder Bublaku dhe Naim Mujaj - KUR Prishtina, Jashar Kastrati – institucioni i Avokatit të Popullit dhe Valdete Daka, Xhemajl Peçani, Miradije Meha – KQZ, Lage Olofsson, Çerkin Morina, Imer Vitija, Ibrahim Gjylderen dhe Valbon Bytyçi – ZAP.

Të pranishëm: Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Fatime Qorri - zyrtare ligjore, Musa Rudaku – zyrtar i fushës për ekonomi dhe financa, KIPRED (staf mbështetës)-Artan Venhari dhe Albert Krasniqi, Shpresa Miftari – praktikante. Qëndresa Mulaj dhe Fjoralba Sylaj – ZAP, Besnik Ramadanaj – KDI.

Mbledhjen e kryesoi Haki Shatri - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 15. 06. 2010 dhe të 18. 06. 2010,
3. Shqyrtimi i Raportit final të auditimit për pasqyrat financiare të Kompanisë së Ujësjetës Rajonal Prishtina për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009,
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2009,
5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit Qendror Zgjedhor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009,
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 15. 06. 2010 dhe të 18. 06. 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi procesverbalin e mbledhjeve të 15 qershorit 2010 dhe të 18 qershorit 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit final të auditimit për pasqyrat financiare të Kompanisë së Ujësjellësit Rajonal Prishtina për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009

Kryesuesi – Pasi i njoftoi të pranishmit për rregullat e mbledhjes, i ftoi përfaqësuesit e ZAP-it ta paraqitnin Raportin.

Ibrahim Gjyliden – **zv.auditor i përgjithshëm** – Lidhur me pasqyrat financiare është dhënë “*opinion i pakualifikuar*”. KUR-i ka një mungesë të politikës së qartë të shkruar - kritere se si të shlyhet një llogari e arkëtueshme. Funksionimi i *softuerit* të brendshëm - ka rezultuar me disa gabime teknike, nuk ka pasur kontroll në rrjetin e ujit në të gjitha rajonet. Janë disa fshatra, të cilat ilegalisht janë lidhur në rrjet. Është krijuar një marrëveshje joformale ndërmjet menaxhmentit dhe banorëve të fshatrave që inkasimin ta bëjnë vetë fshatarët. Këta kanë qenë punëtorë joformalë të Kompanisë, nuk kanë pasur kontrata dhe kanë qenë pjesë e listës së pagave. Nuk është bërë vlerësimi i performancës së stafit dhe janë bërë disa lëshime në procedurat e prokurimit. Janë tejkaluar shpenzimet operative. Njësia e Auditimit nuk e ka pasur përkrahjen nga menaxhmenti. Kjo Njësi nuk ka staf të mjaftueshëm dhe menaxhmenti nuk i ka marrë seriozisht rekomandimet e saj.

Skender Bublatu - KUR Prishtina – KUR Prishtina, i ka pranuar të gjeturat dhe rekomandimet e ZAP-it. Bëhet pyetje nëse është problem i komplikuar si pasojë e ligjeve ose si pasojë e mosprocedimit të çështjeve nga gjykata. KUR-i në vitin 2009 i ka proceduar në gjykatë 2000 raste dhe asnjëra nuk është zgjidhur. Rastet sociale janë ngarkesë për KUR-in. Si të trajtohen këto raste? Sa i përket vlerësimit të stafit - Kompania është në proces. Kontrata ose vlera, të paparapara, kanë qenë 6%, nga i gjithë totali. Në vlerën e paplanifikuar hyjnë disa grante qeveritare, të cilat nuk janë planifikuar. Këto grante kanë ardhur pasi është përgatitur plani. Lidhur me *softuerin* ka avancime. Plani i investimeve kapitale është realizuar në masë të madhe, por reflektimi kryesor ka qenë rritja e shpenzimit të energjisë elektrike - vlera financiare i ka tejkaluar rreth 400 mijë euro. Kompania nga AKM-ja i ka trashëguar dy kontrata për furnizime me kimikate. Në këtë vit është punuar në shumë rregullore të brendshme. KUR-i Prishtina zotohet se do t'i bëjë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar të gjitha rekomandimet.

Synavere Rysha – Shtatë prej dhjetë rekomandimeve të auditorit janë në proces, ndërsa tri nuk janë adresuar ende, si: “...Kompania nuk ka arritur të bëjë analizë dhe trajtim të duhur të arkëtueshmeve si dhe vlerësim të drejtë të pozicioneve për borxhe të këqija dhe të dyshimta, të bëjë vlerësimin vjetor të stafit, të nxjerr rregullore të shkruara të mjaftueshme për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm...”.

Lidhur me kategoritë, të cilat duhet të lirohen nga pagesa, është e vërtetë se nuk ka diçka të saktësuar. Është mirë që Kompania të ketë rregullore të brendshme. Kjo do ta rriste performancën e saj.

Riza Smaka – Raporti i ZAP-it ka konkluzione për lëshime dhe për menaxhime të dobëta. Si është e mundur që KUR-i të mos ketë kontroll në rrjetin e tij? Sipas Raportit ka pasur shumë ankesa, si pasojë e arkëtimit të gabueshme. Afër 300 mijë euro janë faturuar gabimisht. Ky është një gabim shumë i madh. Menaxhmenti i Kompanisë nuk ka arritur të sigurojë kontrole të mira në burime njerëzore. Si mund të ndodhë kjo? Ka numër të të punësuarve që nuk janë në listë të pagave. A do të thotë kjo se këta punëtorë nuk kanë fare kontrata? Prokurimi bëhet në mënyrë të kundërligjshme. Kompania nuk ka kornizë të brendshme ligjore, s'ka kontroll mbi paranë, mbi personelin etj. Për këto lëshime menaxhmenti duhet jo vetëm të shkarkohet menjëherë, por edhe të japë llogari.

Anita Morina – Saraçi – Tha se menaxhimi jo i drejtë, punësimi pa kontratë, gabimet *softuerike* krijojnë situata, në të cilat çdoherë dëmtohen konsumatorët e përgjegjshëm. Këto parregullsi do të tejkaloheshin me rregulloren e Kompanisë në përputhje me Ligjin për ndërmarrje publike. Si është gjendja sot, sepse Raporti flet për vitin 2009? Ku kanë arritur me të gjeturat? A ka Kompania plan për arritjen e marrëveshjes apo nënshkrimin e kontratave me ata që janë lidhur ilegalisht në rrjetin e ujësjellësit?

Enis Kervan – Tha se Raporti është i mirë, krahasuar me raportet e tjera. Si qëndron çështja e punëtorëve që nuk kanë kontratë? Ku është pengesa që nuk janë përgatitur rregulloret e brendshme?

Kryesuesi – Çështja e provizioneve dhe e borxheve të këqija, a ka ndikuar në pozitën materiale të Kompanisë, përkatësisht në keqmenxhimin dhe humbjen në substancë të parasë publike?

Ibrahim Gjylderen – zv.auditor i përgjithshëm – Në Raportin e pasqyrave financiare provizionet dhe borxhet e këqija nuk kanë ndikuar në pasqyrimin real financiar. Sa i përket menaxhimit ka munguar një dokument i shkruar, se kur një borxh i konsumatorit bëhet borxh i keq.

Skender Bublatu - KUR Prishtina – Me Ligjin për NP, MEF-i ka për detyrë të përgatisë rregullore. Në mungesë të kësaj KUR-i ka përgatitur rregullore në bazë të kornizave ligjore. Ka një performancë të stafit që vlerësohet nga rregullatori. Kontrolli i rrjetit – është munduar ta fusë gjithë sistemin e ujit, por ka probleme me ata që janë lidhur me gypa magjistrat. KUR është në proces të rregullimit të kësaj, si: dërgimi i faturave individuale dhe ankesat në faturim. KUR-i ka 85 mijë banor shfrytëzues dhe ekziston mundësia e gabimeve teknike. 300 mijë euro të faturuara gabimisht, është fjala në vlerën totale të faturimit 1%, është vlerë simbolike. Shumë nga adresimet e ZAP-it janë në proces të zgjedhjes. Sa u përket lidhjeve ilegale, KUR-i ka lënë një afat deri më 30 korrik, që të gjithë ata të cilët janë lidhur në mënyrë ilegale të paraqiten në Kompani për ta legalizuar lidhjen.

Kryesuesi konstatoi se KMFP-ja, njëzëri ka vendosur që Kuvendit t'i

REKOMANDOJË

1. Të miratohet Raporti me rekomandime i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për pasqyrat financiare të Kompanisë së Ujësllësit Rajonal Prishtina për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009.

2. Detyrohet Kompania Ujësllësi Rajonal Prishtina, që në afat prej 30 ditësh, nga dita e miratimit të këtij Raporti, me anë të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ta njoftojë Kuvendin për veprimet që janë marrë për përmbushjen e rekomandimeve të raportit të ZAP-it.

4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2009

Qerkin Morina, zv.auditor i përgjithshëm – Gjetjet kryesore të këtij auditimi janë: menaxhimi i dobët i donacioneve, mungesa e kontrollit të brendshëm dhe mungesa e politikave dhe e procedurave të brendshme lidhur me shfrytëzimin e donacioneve. IAP-ja i ka kryer aktivitetet e veta operative në pajtim me ligjin dhe si organizatë e vogël, ka pasur realizim të buxhetit në shkallën prej 70%. Ka mangësi të vogla në shpenzime për mallra dhe shërbime. Vlerësimi dhe hapja e tenderëve në 6 raste është bërë pa vendimin e drejtorit ekzekutiv për formimin e komisionit. Në një rast tenderi është dhënë me më pak se tri oferta. Në një rast mungon kërkesa për nismën e procedurave të prokurimit, kurse në një tjetër menaxheri i prokurimit e ka bërë pranimin e mallit të prokurimit, që do të thotë se nuk është bërë ndarje e detyrave në pajtim me LPP-në. Donacionet kanë qenë kryesisht të destinuara për paga, për mëditje dhe për mallra e shërbime. Me auditim është vërejtur se IAP-ja nuk ka ofruar marrëveshje të shkruar për

shfrytëzimin e këtyre mjeteve dhe nuk ka raport për mënyrën si janë shfrytëzuar këto donacione. Regjistrimi i pasurive në sistemin e “free ballance” - disa janë regjistruar në sistem, ndërsa në evidenca kontabël të IAP-së nuk janë të regjistruara. Në pajtim me UA 21/2009, parashihet të bëhet zhvleftësimi i pasurive, por kjo nuk ka ndodhur. Është vërejtur se ka pas fluks të punës dhe nuk është bërë pranim-dorëzimi i inventarit të punës. IAP-ja nuk ka njësi të auditimit të brendshëm.

Jashar Kastrati – institucioni i Avokatit të Popullit – Lidhur me të gjeturat IAP-ja ka marrë veprime konkrete dhe janë eliminuar, me përjashtim të donacioneve. Lidhur me këtë IAP-ja ka filluar ta ndryshojë gjendjen. Aktualisht janë duke i identifikuar projektet.

Riza Smaka – Pse është bërë menaxhimi i dobët i donacioneve? Pse ka dobësi në auditimin e brendshëm? Pse nuk janë planifikuar shpenzimet e donacioneve? Pse IAP-ja nuk i ka përgatitur pasqyrat financiare në përputhje me Rregulloren 2009/20? Pse kontratat nuk nënshkruhen nga personat kompetentë? Pse punësohen personat, të cilët nuk i plotësojnë kushtet?

Synavere Rysha – Qëllimi i debatit duhet të orientohet në atë drejtim që raporti i auditorit të pranohet drejt, rekomandimet e auditorit të pranohen dhe të ketë rezultate pas një apo dy muajve. IAP-ja është institucion i vogël dhe ka numër të vogël të të punësuarve. Kjo ia pamundëson të ketë auditor të brendshëm.

Kosara Nikoliq - Konstatoj se nuk është bërë regjistrimi i pasurisë së paluajtshme. Edhe kjo pasuri e luan rolin e vet në shpenzimet buxhetore. Pse ndodh që në IAP, me rastin e testimit të kandidatëve, ka lëshime? IAP-ja duhet të jetë shembull për institucionet e tjera. Pse nuk janë formuar komisionet me rastin e tenderëve dhe nuk janë respektuar procedurat e tri ofertave etj.?

Kryesuesi – ZAP-i ka konstatuar gjetje. Ka gjetje të natyrave subjektive, të cilat mund të evitohen, p.sh. me një marrëveshje bashkëpunimi me një organizatë tjetër buxhetore që IAP-ja të ketë një komision të auditimit të brendshëm, sepse auditimi i brendshëm ndihmon shumë në evitimin e gabimeve.

Jashar Kastrati – institucioni i Avokatit të Popullit – Donacionet nuk kanë qenë aktive. Tani këto donacione kanë filluar të aktivizohen. Lëshim lidhur me pasqyrat financiare në këtë vit nuk do ketë. Gjetjet lidhur me procedurën e punësimit janë përgjegjësi e menaxhmentit të kaluar, ndërsa lëshimet e prokurimit tashmë janë evituar.

Kryesuesi konstatoi se KMFP-ja njëzëri vendosi që Kuvendit t'i

REKOMANDOJË

1. *Të miratohet Raporti me rekomandime i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për pasqyrat financiare të institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2009.*
2. *Detyrohet institucioni i Avokatit të Popullit të punojë në programin e gjetjeve, në zbatimin e rekomandimeve të ZAP-it dhe lidhur me këtë në afat prej 30 ditësh, nga dita e miratimit të këtij Raporti, ta njoftojë Kuvendin nëpërmjet Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.*

5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit Qendror Zgjedhor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009

Çerkin Morina - zv.auditor i përgjithshëm – I njoftoi anëtarët e Komisionit se opinioni i auditorit për punën që është bërë në KQZ është “*opinion i kualifikuar*”. Kjo ka ndodhur për shkak se depozitat e pranuar nga subjektet politike dhe nga pasuritë që janë problem i përgjithshëm, nuk janë shpalosur në pasqyra financiare. Këto depozita kapin një shumë prej 217

mijë euro. Krahasuar me buxhetin që e ka KQZ-ja ka pasur ndikim material për dhënien e opinionit. Pasqyrat financiare nuk janë të sakta. Disa mospërputhje ndërmjet pasqyrave dhe evidencave të thesarit janë vërejtur edhe te shpenzimet. Shpenzimet sipas thesarit janë më të mëdha për 40 mijë euro se sa ato që janë paraqitur në pasqyrat financiare. Depozitat në shumën prej 217 600 euro janë në thesar, mirëpo në pasqyra financiare nuk janë regjistruar fare. Buxheti total i KQZ-së është shfrytëzuar 62%. Prej tyre, për paga dhe për mëditje janë shpenzuar 86%. Te shpenzimet e buxhetit për paga dhe për mëditje janë identifikuar disa mangësi, që lidhen drejtpërdrejt me shpenzimin për këtë qëllim. Kjo do të thotë se në dy raste kontratat nuk kanë qenë fare të nënshkruara. Në një rast një zyrtar është paguar pa kontratë prej muajit janar deri në muajin prill të vitit 2009. Në një rast tjetër, një zyrtari i janë dhënë edhe paga edhe shtesa, pa u paraqitur fare në punë nga muaji korrik deri në muajin tetor 2009. Nuk janë respektuar kërkesat më themelore që dalin nga Ligji i prokurimit publik, siç është afati i liverimit, vonesa në dërgimin e mallrave. Në pesë raste të tjera pranimi i mallrave është bërë nga persona jokompetentë. Në një rast procedurat e prokurimit janë filluar pa zotimin e fondeve të nevojshme. Në rast tjetër ka tejkalim të kontratës, e cila është lidhur në bazën e kuotimit të çmimit, mirëpo kjo më vonë ka rezultuar me një mbipagesë, në shumën mbi 12 mijë euro. KQZ-ja ende nuk ka arritur ta ketë një regjistër të plotë të informatave për pasurinë, si dhe nuk e ka caktuar një zyrtar të pasurive, ashtu siç kërkohet me ligj. Edhe këtu nuk është llogaritur zhvlerësimi i pasurive (Udhëzimi administrativ 21/2009), edhe pse kjo është një çështje mjaft e komplikuar. Në KQZ auditori i brendshëm, si funksion, nuk ekziston.

Valdete Daka - kryetare KQZ – Ka pranuar detyrën tri javë më parë dhe ndoshta mund të mos jetë e informuar mirë. I pranoj në tërësi rekomandimet, që janë dhënë nga ana e auditorit. Sa i përket auditimit të brendshëm, KQZ-ja është organizatë e vogël, me një staf të vogël, mirëpo në të ardhmen në bashkëpunim me auditorin e përgjithshëm, ose ndonjë organizatë tjetër buxhetore, do të mundohet të ketë auditim të brendshëm.

Xhemajl Peçani – Auditimi është bërë për periudhën, kur KQZ-ja për herë të parë i ka organizuar zgjedhjet e përgjithshme. Ka qenë një proces zgjedhor me shumë specifika dhe një periudhë me shumë afate të ngjeshura. Për një periudhë të shkurtër është dashur të bëhen disa shpallje për tenderë dhe për prokurime. Lidhur me çështjen e dy zyrtarëve, njëri në Pejë, tjetri në Zveçan, KQZ-ja i është përgjigjur ZAP-it. Në momentin kur zyrtarja është kërkuar nga auditori nuk ka qenë aty dhe faktikisht nuk ka qenë i protokolluar, por më vonë është dërguar. ZAP-i ka probleme me Zveçanin Leposaviqin dhe Zubin Potokun. Ka pasur kontakte me zyrtarët atje, por nuk kanë qenë në dijeni se nuk gjendet në vendin e punës. Një çështje tjetër me rëndësi është edhe pranim-dorëzimi i mallit, që është një proces shumë i komplikuar. Mund të ndodhë që në të njëjtin moment të vijë prej shumë operatorëve ekonomikë. Në përgjigjen e ZAP-it për auditorin është thënë se pranimi i mallit është bërë nga zyrtari përkatës. Çështja e liverimit - nuk është faji i operatorëve ekonomikë, por i KQZ-së, sepse nuk ka qenë në gjendje ta funksionalizojë këtë. Operatorit ekonomik i është dashur të presë dy deri në tri ditë për ta sjellë mallin. Janë disa pagesa të KKZ-ve, që janë evidencuar edhe nga auditori. Ishte obligim i partive politike të delegojnë anëtarët e KKZ-ve. Për njëmbëdhjetë rastet, që janë evidencuar nga auditori, KQZ-ja nuk ka pasur qasje t'i kontrollojë, ngase partitë politike i kanë dërguar ata. Ata janë të evidencuar se marrin edhe pagesë nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe njëri prej tyre është i komunitetit shqiptar, kurse të tjerët janë të komuniteteve të tjera.

Synavere Rysha – Për dallim nga raportet e tjera, ky Raport ka opinion të kualifikuar të auditorit. E inkurajoj auditorin që për një periudhë sa më të shkurtër ta bëjë një auditim, se si qëndron puna me rekomandimet që i ka dhënë për KQZ-në.

Kryesuesi – Meqë kemi një raport, që për nga opinioni quhet i kualifikuar, na bënë të kuptojmë se këtu kemi dëmtim material të parasë publike. Këtë e vërteton sidomos pjesa që lidhet me pasqyrat financiare, të cilat auditori i cilëson si të pasakta, se përmbajnë informacione të gabuara ose jo të plota për shpenzimet dhe për depozitat në vlerë përafërsisht 250 mijë euro. Propozoj që Komisioni t'i rekomandojë Kuvendit ta shqyrtojë dhe ta miratojë këtë Raport, ndërsa KQZ-ja të

detyrohet që në afat të caktuar, nga data e miratimit në Kuvend, t'i adresojë të gjitha angazhimet e saj për eliminimin e gjetjeve. Mosevidencimi i depozitave të partive politike ose të kujdoqofshin, ose mosevidencimi i pasqyrave financiare, i shpenzimeve dhe mospërputhja e tyre me raportin e thesarit, janë shkelje materiale. Komisioni është i thirrur për këtë që të kërkojë llogari publike.

Naser Osmani – Raporti është i kualifikuar dhe nëse si i tillë procedohet për shqyrtim në seancë, nuk do të kalojë. Meqenëse është auditimi i parë për KQZ-në dhe ky institucion me aq përgjegjësi për herë të parë ka organizuar zgjedhje, propozoj që KQZ-së t'i jepet një afat me mundësi për mirësimin. KQZ-ja duhet ta njoftojë Komisionin (brenda dy muajve) për progresin që ka arritur në përmirësimin e të gjeturave dhe në përmbushjen e rekomandimeve që janë bërë nga auditori i përgjithshëm. KQZ-ja duhet të orientohet në fuqizimin dhe ngritjen e kapaciteteve në Departamentin për Financa, sepse me Ligjin për financimin e partive politike, KQZ-ja do t'i shpërndante mjetet financiare, pastaj auditimi i brendshëm që është me shumë me rëndësi që dikush t'i paraprijë këtij institucioni me udhëzime, rekomandime, si dhe çështja e prokurimit.

Synavere Rysha – Nuk u pajtua me propozimin e deputetit Naser Osmani, sepse, sipas saj i vetmi raport që duhet të procedohet në seancë për shqyrtim është raporti i ZAP-it, i cili nuk bën të ndryshohet. E vetmja mënyrë është që KQZ-ja, pasi të përgatisë raport për veprimet e ndërmarra, duhet t'ua procedoj këtë raport ZAP-it dhe KMFP-së. Raportit do t'i bashkëngjitet raporti i auditorit në mënyrë që ta zbusim situatën. Lidhur me këtë kërkoj mendim profesional nga auditori.

Naser Osmani – Tha se propozimi i tij nuk kishte të bënte me ndryshimin e Raportit, por ai kërkoj që KQZ-së t'i ofrohet afat prej dy muajsh për përmirësimin e tri segmenteve: financa, auditim i brendshëm dhe prokurim. Për veprimet e ndërmarra, KQZ-ja duhet t'i raportojë KMFP-së.

Lage Olofsson - Është shumë e rëndësishme që Komisioni ta ketë mënyrën si t'i trajtojë raportet për të cilët ka opinion të kualifikuar. Në tërësi mund të jenë rreth 40 raporte që do të procedohen për shqyrtim. Është shumë e rëndësishme të dihet si do të trajtohen këto në Kuvend. Ai nuk ka përgjigje për këtë. ZAP-i nuk dëshiron ta mbingarkojë Kuvendin.

Kryesuesi – Me ligj kemi limit kohor, që raportet e auditorit të shqyrtohen në Kuvend, jo më larg se muaji tetor. Në rast se këto raporte nuk shqyrtohen, automatikisht konsiderohen “*të miratuara*”. Ishte i mendimit se Komisioni duhet t'i japë shtytje KQZ-së, që brenda dy muajve të raportojë para këtij Komisioni lidhur me veprimet e ndërmarra. Kjo e ndihmon Kuvendin ta shohë gjendjen reale.

Riza Smaka – Ishte kundër që të dëgjohet mendimi i auditorit në këtë mbledhje, sepse e ka dhënë me shumë kompetencë mendimin e vet në Raport. Këto gjetje nuk do të duhej të ndodhnin në KQZ, në të cilin ka njerëz kompetentë. Dorëzim-pranimi i mallit është problem, por te kontratat e shitblerjes, dorëzim-pranimi i mallit është elementar. Pranimin e bën përfaqësuesi i entitetit legal, i autorizuar, sepse duhet bëhet kontrata, në të cilën duhet të përfshihen: sasia, cilësia, vendi, koha, që janë shumë të rëndësishme për realizimin e kontratës për shitblerje. Po ashtu, në faqen numër 7, te pagat dhe mëditjet, buxheti fillestar është gati gjysmë për gjysmë më i vogël se ai i rishikuari. Pse pasqyrat financiare për vitin 2009, janë të pasakta? Kur ato janë të pasakta ka bazë për të dyshuar në spekulime, manipulime dhe abuzime. Pse regjistri kontabël i pasurisë nuk është i plotë dhe i saktë? Pse nuk janë bërë harmonizime të rregullta me thesarin për depozitat e paguara? Pse nuk bëhet përfillja e procedurave për themelimin e marrëdhënieve të punës? Operatorët ekonomikë duhet të jenë gjithsesi të regjistruar dhe duhet t'i përfillin të gjitha dokumentacionet - në raport del e kundërta. Paga pa kontratë, nuk mund të tolerohet, kur kemi të bëjmë me paranë publike. U pajtua me mendimin për t'ia dhënë një afat këtij institucioni, për të raportuar për arritjet para KMFP-së.

Miradije Meha - KQZ - Çështja e depozitave në shumën prej 217 mijë eurosh, ka të bëjë me gjobat të cilat i ka caktuar KZAP-i. Si pasojë e mosaktivizimit me kohë të KZAP-it, gjobat të cilat është dashur t'i paguajnë partitë politike, me qëllim që t'u mundësohet pjesëmarrja në zgjedhje, KQZ-ja ka marrë vendim që këto gjoba të paguhen në llogarinë e KQZ-së. KQZ-ja nuk i ka evidencat për këto gjoba. Shuma prej 40 mijë eurove, është shuma që e kanë paguar subjektet politike për t'u certifikuar. Subjekteve politike, që marrin pjesë në zgjedhje, u kthehet kjo shumë. Pjesa tjetër prej 177 660 eurove, është gjobë e shkaktuar nga KZAP-i. Shuma prej 40 mijë e 510 eurove, është shumë nga një donacion gjerman. Ky donacion figuron në pasqyra financiare, mirëpo në një pjesë nuk është pasqyruar për arsye teknike.

Kryesuesi konstatoi se KMFP-ja njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

- 1. Detyrohet KQZ-ja që brenda dy muajve të përgatisë dhe të dorëzojë raport lidhur me veprimet e ndërmarra për të gjeturat dhe për rekomandimet e ZAP-it.*
- 2. Në rast të mosprocedimi të raporti të KQZ-së brenda këtij afati, KMFP-ja do ta procedojë raportin e ZAP-it për shqyrtim dhe për miratim në seancë plenare.*

Mbledhja përfundoi në orën 14:15

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Haki Shatri